



Dizenjimi dhe zbatimi i një strategjie për Partneritet Publik Privat në Bashkinë e Korçës

Qëllimi i projektit

Ky projekt kishte si fokus përmirësimin e qeverisjes vendore duke ofruar shërbim më të mirë dhe rritjen e mirëqënies për komunitetin. Bashkia e Korçës synoi arritjen e këtyre objektivave duke investuar në përmirësimin e kushteve të banimit për familjet në nevojë dhe duke menaxhuar me efikasitet asetet që kanë kaluar nga shteti në pronësi të bashkisë. Një nga alternativat më të sukseshme në këtë fushë që ka gjetur zbatim në shumë vende, është dhe Partneriteti Publik Privat i cili gërsheton së bashku ekspertizën dhe kapacitetet e sektorit privat me mundësitë e reja për investim që ofrohen nga sektori publik me qëllim agjërimit dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

Objektivat kryesore të projektit

1. Përmirësim i menaxhimit të aseteve lokale- ngritje kapacitetesh për stafin e administratës publike dhe përfaqësuesve të zgjedhur për këtë çështje si dhe zhvillimin e modeleve që mund të adaptohen në situata të ngjashme në të ardhmen.
2. Tërheqja e investitorëve privatë drejt vënies në funksionim të zonave urbane të papërdorura që mund të shndërrohen potencialisht për zgjidhjen e nevojave për strehim si dhe shërbime të tjera për komunitetin.



Detyrat kryesore të projektit

- Përgatitja e një seti të plotë dokumentesh mbështetur në kuadrin ligjor për zhvillimin e një PPP të suksesshëm
- Mbledhja dhe analiza e të dhënave financiare, inxhinierike dhe teknike në lidhje me përdorimin e mëparshëm, aktual dhe të mundshëm në të ardhmen të pronës që është dhe objekt i projektit. Prezantimi i alternativave të mundshme për investim që janë atraktive për sektorin privat.
- Asistencë e ofruar në analizën e burimeve të ndryshme të financimit që mund të përdoren për infrastrukturën, nëpërmjet burimeve të veta të Bashkisë ose huamarrjes në banka tregtare.
- Analizë e situatës financiare të bashkisë si dhe parashikim i të ardhurave dhe shpenzimeve duke u mbështetur mbi politikën dhe paketat fiskale të reja si dhe efektet e faktorëve makroekonomike në vitet e ardhshme kohëzgjatja e projektit.
- Krijimi dhe përzgjedhja e indikatorëve dhe parametrave konkretë për projektin si dhe asistencë në përgatitjen e një modeli PPP që mund të zbatohet për pronën publike.
- Asistencë dhe mbështetje në ngritjen e strukturave përkatëse dhe institucionalizimin e

një procesi të mirëfilltë konkurrues përzgjedhës të investitorit privat potencial për zbatimin e PPP.

- Ngritje e kapaciteteve dhe ekspertizës në administratë për zbatimin dhe përcjelljen e njohurive të këtij procesi në situata të ngjashme në të ardhmen.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ ARD/USAID

KOHËZGJATIA:

Shkurt 2009 – Qershor 2009

PËRFITUESIT:

- ✓ Bashkia Korçë

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtore Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.